

RENDI RAJONAL DHE GLOBAL

# NJË SHTYTJE PËR ZGJERIMIN

**Ditmir Bushati**  
Dhjetor 2023



Zhvillimet në lindje të kontinentit janë në kontrast të fortë me Ballkanin Perëndimor, ku elitat politike në përgjithësi kanë kultivuar ndjenjën e vetëkënaqësisë duke ofruar zgjidhje të thjeshta për probleme komplekse dhe bindjen se mund mund të vazhdojnë të tregojnë në mënyrë cinike fabulën e anëtarësimit në BE.



Diferenca qëndron tek mungesa e vullnetit politik që është i pazëvendësueshëm në këtë proces. Kjo është arsyeja që Ballkani Perëndimor vijon të jetë në karusel. Po aq larg BE-së sa edhe para realitetit të ri gjeopolitik që jetojmë, si pasojë e pushtimit të Ukrainës nga ana e Rusisë, pavarësisht përsëritjes së retorikës përbetuese të dyanshme për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, si synim strategjik i dyanshëm.



Kontrasti tjetër mes lindjes dhe jugut të kontinentit është mënyra se si shikohet BE-ja nga elitat politike. Në Ukrainë e Moldavi ajo shikohet në mënyrë idilike, si një komunitet vlerash. Në Ballkanin Perëndimor shikohet si një mundësi se si BE-ja mund të "ballkanizohet" apo riformatohet, për shkak të kompromentimit të vlerave dhe standardeve të procesit të zgjerimit, sidomos gjatë dekadës së fundit.

RENDI RAJONAL DHE GLOBAL

# NJË SHTYJE PËR ZGJERIMIN

Dhjetë vjet pasi shpërthyen protestat pro BE-së në sheshin Maidan të Kievit, për shkak se presidenti i atëhershëm ukrainas refuzoi të nënshkruante marrëveshjen e asociimit me BE-në, udhëheqësit e BE-së, në mbledhjen e fundvitit morën një vendim me përmasa historike: hapjen e bisedimeve për anëtarësim për Ukrainën, e goditur nga agresioni rus, dhe për Moldavinë, e cila dy vitet e fundit ka ndërmarrë reforma të rëndësishme. Nëse kjo mbledhje do të përfundonte pa një vendim për Ukrainën, për shkak të kundërshtisë së Hungarisë, BE-ja do të dukej e dobët dhe Komisioni do të akuzohej se kishte premtuar tepër për Ukrainën. Dëmi që kjo do t'i sillte reputacionit të BE-së do të ishte i pakthyeshem.

Në shenjë inkurajimi, gjithashtu, BE-ja i dha Gjeorgjisë statusin e vendit kandidat. Ndërsa Bosnje-Hercegovina bëri hapa milimetrikë drejt tryezës së bisedimeve për anëtarësim në BE. Ky është lajmi i parë i mirë nga mbledhja e fundvitit e udhëheqësve të BE-së.

Kur Komisioni European në qershor të vitit 2022 rekomandoi statusin e kandidatit për Ukrainën dhe Moldavinë, ai parashtroi respektivisht shtatë dhe nëntë kushte për t'u përmbushur nga këto vende, me qëllim fillimin e bisedimeve të anëtarësimit në BE. Këto kushte ishin kryesisht, por jo ekskluzivisht, të lidhura me reformat e shtetit të së drejtës. Sipas paketës së zgjerimit të paraqitur nga Komisioni European, më 8 nëntor 2023, Ukraina ka plotësuar vetëm katër nga shtatë kushte dhe Moldavia gjashtë nga nëntë kushte. Ndërsa Gjeorgjia, ka plotësuar vetëm tre nga dymbëdhjetë kushtet e vendosura verën e kaluar.

Qoftë paketa e zgjerimit ashtu dhe vendimarrja e BE-së reflektojnë një klimë më të favorshme për zgjerimin, krahasuar me vitet e shkuara. Pushtimi rus i Ukrainës ka ringjallur debatin e zgjerimit dhe të ardhmen e projektit european. Shumica e vendeve anëtare të BE-së e shohin atë si një mënyrë për t'iu përgjigjur realitetit gjeopolitik dhe për të forcuar BE-në në fqinjësinë e saj të afërt. Megjithatë, mbetet e paqartë nëse zgjerimi i BE-së do të mund të materializohet.

Treshja e vendeve të Fqinjësisë Lindore është nën trajtat e ndryshme të presionit e pushtimit nga ana e Ruisë. Kësisoj, vendimarrja e BE-së përcakton jo vetëm një vijë ndarëse mes botës euroatlantike dhe asaj euroaziatike, por njëkohësisht dëshmon se shtytja e zgjerimit nga ana e BE-së është një aset i fortë gjeopolitik, për shkak të fuqisë tërheqëse të saj.

Në mënyrë të paprecedentë, vendimi për Ukrainën u mor në kushtet e abstenimit të Hungarisë, kryeministri i së cilës la sallën në momentin e vendimarrjes, duke e konsideruar atë si një vendim të gabuar nga ana e BE-së. Nga ana tjetër, kryeministri Orbán pengoi vendimarrjen e BE-së për disbursimin e fondeve aq shumë të nevojshme për Ukrainën, me argumentin se një gjë e tillë sjell pasoja në zbatimin e projekteve të parashikuara të BE-së për qytetarët e vendit të tij.

Negociatat me Ukrainën dhe Moldavinë nuk do të nisin menjëherë. Udhëheqësit e BE-së ngarkuan Këshillin që të miratojë kornizat përkatëse të negociatave pasi të përmbushen rekomandimet e Komisionit European të datës 8 nëntor 2023. Thënë ndryshe, vendimi i Këshillit European është një vendim në parim. Komisioni European duhet të paraqesë një raport për përmbushjen e rekomandimeve në mënyrë që vendet anëtare të BE-së të miratojnë më pas në mënyrë unanime kornizën negociuese. Një minimum prej 70 vendimesh unanime do të kërkohen gjatë viteve të ardhshme në rrugën e anëtarësimit të Ukrainës në BE.

Këshilli European i dha Gjeorgjisë statusin e vendit kandidat, me mirëkuptimin se janë ndërmarrë hapat e përcaktuara në rekomandimin e Komisionit European, ndërsa Bosnje-Hercegovina do të hapë negociatat e anëtarësimit pasi të arrihet shkalla e nevojshme e përputhshmërisë me kriteret e anëtarësimit. Këshilli fton Komisionin të raportojë mbi progresin e bërë nga Bosnje-Hercegovina në këtë drejtim, jo më vonë se marsin e ardhshëm, me synimin marrjen e një vendimi. Ky formulim i shoqëruar me një afat kohor të përcaktuar e vendos Bosnje-Hercegovinën para përgjegjësisë për të përmbushur kritoret e listuara nga Komisioni European me

qëllim nisjen e procesit të bisedimeve për anëtarësim në BE.

Interesant është fakti se vendimarrjet e mësipërme u pritën me entuziazëm dhe festime në Ukrainë, Moldavi e Gjeorgji, ndërsa në Bosnje-Hercegovinë me heshtje.

Për ta kuptuar “udhëtimin e një vendi drejt BE-së”, mund të vlejë shembulli i udhëtimit me avion. Statusi i vendit kandidat është pak a shumë i ngjashëm me situatën kur blejmë një biletë për të udhëtuar. Vendimi për hapjen e bisedimeve me marrjen e kartës së imbarkimit dhe kalimin e kontrollit policor e fizik në aeroport, që na bën gati për udhëtim. Ndërkohë që miratimi i kornizës së negociatave ngjan me momentin e hipjes në avion. Vetë procesi i bisedimeve është një fluturim i gjatë me shpresën dhe urimin që të arrihet në mënyrë të sigurtë në destinacion dhe pa turbulenca.

## BALLKANI PERËNDIMOR NË KARUSEL

Zhvillimet në lindje të kontinentit janë në kontrast të fortë me Ballkanin Perëndimor, ku elitat politike në përgjithësi kanë kultivuar ndjenjën e vetëkënaqësisë duke ofruar zgjidhje të thjeshta për probleme komplekse dhe bindjen se mund të vazhdojnë të tregojnë në mënyrë cinike fabulën e anëtarësimit në BE, pa pronësi mbi reformat që sigurojnë transformim thelbësor.

Diferenca qëndron tek mungesa e vullnetit politik që është i pazëvendësueshëm në këtë proces. Kjo është arsyeja që Ballkani Perëndimor vijon të jetë në karusel. Po aq larg BE-së sa edhe para realitetit të ri gjeopolitik që jetojmë, si pasojë e pushtimit të Ukrainës nga ana e Rusisë, pavarësisht përsëritjes së retorikës përbetuese të dyanshme për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, si synim strategjik i dyanshëm.

Takimet e përbashkëta të BE-së me Ballkanin Perëndimor nuk e mbulojnë dot simbiozën e pandershmërisë intelektuale që mbizotëron në këtë proces. Një pjesë e vendeve të rajonit presin që të promovohen duke identifikuar dobësitë ekzistuese të vetë BE-së, në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e sundimit të së drejtës. Zhbllokimi i fondeve të BE-së ndaj Hungarisë, pavarësisht rrënimit të standardeve të sundimit të së drejtës, në këmbim të lejimit të vendimarrjes për hapjen e negociatave me Ukrainën, vendos pikëpyetje të forta për kushtëzimin demokratik e financiar si element i rëndësishëm në procesin e transformimit demokratik. Po të shtosh këtu edhe raportet e Komisionit Europian, të cilat janë më shumë përshkruese sesa diagnoztikuese, kuptohet

qartë se konsolidimi i projektit europian në këtë kënd të Europës kërkon para së gjithash vullnet politik të dyanshëm.

Faktet flasin qartë. Që prej vitit 2017, kur mbylli tre kapituj të negociatave me BE-në, Mali i Zi nuk ka hedhur asnjë hap të mëtejshëm në këtë proces. Pavarësisht se në tryezën e bisedimeve me BE-në prej rreth një dekade, Serbia vijon të sfidojë rregullat bazë të rendit ndërkombëtar të vendosur në rajon pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë, duke kundërshtuar në çdo mënyrë shtetësinë e Kosovës, funksionalitetin e Bosnje-Hercegovinës dhe Malit të Zi. Fotografia e tubimit të fitores së zgjedhjeve parlamentare të 17 dhjetorit, ku Presidenti i Serbisë shoqërohej nga Presidenti i Republikës Srpska të Bosnje-Hercegovinës, Kryetari i Parlamentit të Malit të Zi, ministri i çështjeve të sigurisë të Bosnje-Hercegovinës, sikur të ishin pjesë e skuadrës elektorale, flet më shumë sesa njëmijë fjalë.

Zyrtarizimi i kundërshtisë së Greqisë për hapjen e bisedimeve me Shqipërinë për grup kapitullin e parë që ka të bëjë me sundimin e së drejtës ishte një aksident që duhej evituar. Me përjashtim të një episodi të veçuar në vitin 1995 ku Shqipërisë ju bllokua paketa e ndihmës financiare të BE-së, për shkak të kundërshtisë së Greqisë në lidhje me “incidentin e Peshkëpisë”, kjo e fundit ka qenë gjithnjë mbështetëse e rrugës europiane të Shqipërisë.

Vetoja është një aset i fuqishëm, por që përdoret rrallë në politikën e BE-së. Historia e fqinjëve na tregon se Greqia mund të shpenzojë kapital politik-diplomatik deri në përmbushjen e objektivit, edhe pse e izoluar nga vendet e tjera anëtare të BE-së. Ndaj, nevojitet angazhim i njëmendtë politik-diplomatik për tejkalimin e kësaj situatë, bazuar mbi parimet dhe vlerat europiane. Aq më tepër kur dihet se në muajin qershor të vitit 2018, Greqia ishte promotore e nisjes së bisedimeve për anëtarësim të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në BE.

Horizonti për hapjen e bisedimeve për grup kapitullin e parë nga ana e Maqedonisë së Veriut mbetet i mbyllur, për shkak të zotimit të papërmbushur e të sanksionuar në kornizën negociuese, për të përfunduar ndryshimet kushtetuese. Me gjasë kjo temë delikate do të rimerret e trajtohet nga fituesit e zgjedhjeve parlamentare të pranverës së vitit të ardhshëm.

Ndërsa BE-ja nuk e ka shqyrtuar aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE, ndonëse ka kaluar një vit, pyetja që kërkon përgjigje është se përse i mohohet Kosovës mundësia për të demonstruar vullnetin politik për transformim? A ka të bëjë kjo veç me pozicionin e ngurtë

të pesëshes mosnjohëse ndaj Kosovës apo edhe me mungesën e kapacitetit të BE për të përfunduar projektet e shtetësisë në rajonin tonë?

Kontrasti tjetër mes lindjes dhe jugut të kontinentit është mënyra se si shikohet BE-ja nga elitat politike. Në Ukrainë e Moldavi ajo shikohet në mënyrë idilike, si një komunitet vlerash. Në Ballkanin Perëndimor shikohet si një mundësi se si BE-ja mund të "ballkanizohet" apo riformatohet, për shkak të kompromentimit të vlerave dhe standardeve të procesit të zgjerimit, sidomos gjatë dekadës së fundit.

## **NJË HARTË RRUGE PËR ZGJERIMIN**

Në këtë kontekst, lajmi i dytë i mirë nga mbledhja e fundvitit të udhëheqësve të BE-së është sigurimi i mbështetjes politike për procesin e reformimit të BE-së, krahas zgjerimit. Pra, angazhimi për miratimin e një udhërrëfyesi brenda verës së vitit të ardhshëm, për reformat që duhet të ndërmarrë BE-ja, për ta bërë atë gati për procesin e zgjerimit dhe qasjen që duhet të ndjekë me kandidatët që synojnë anëtarësimin.

Në Deklaratën e Granadës të 6 tetorit 2023, BE-ja theksoi se zgjerimi është një investim gjeostrategjik në paqe, siguri, stabilitet dhe prosperitet dhe një shtytës për përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale të qytetarëve europianë, duke reduktuar pabarazitë ndërmjet vendeve dhe duke nxitur njëkohësisht respektimin e vlerave mbi të cilat është themeluar BE-ja.

Duke parë perspektivën e një BE-je të zgjeruar me gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe tre vendet e Fqinjësisë Lindore, si aspirantët ashtu edhe BE-ja duhet të jenë gati për procesin dhe kohën e anëtarësimit. Puna në të dy frontet duhet të përparojë paralelisht. Aspirantët duhet të tregojnë vullnet politik për reforma, veçanërisht në fushën e sundimit të së drejtës. Ndërsa vendet anëtare të BE-së duhet të përcaktojnë piketat e reformave të brendshme duke projektuar një BE me ambicie afatgjata, duke adresuar kështu çështjet kyçe që lidhen me prioritetet dhe politikat sikundër me kapacitetin e BE-së për të vepruar.

Udhërrëfyesi që pritet të miratohet para verës së vitit të ardhshëm duhet të parashikojë miratimin e një sërë reformash që pritet të shtyhen përpara gjatë presidencës polake ose daneze në vitin 2025. Një proces i ngjashëm përsa i përket fushës së veprimit me Agjendën e Belinit të vitit 2000, që përgatiti terrenin për procesin e zgjerimit të vitit 2004.

Një agjendë e tillë është e rëndësishme të përshkruajë

reformat kryesore për buxhetin e BE-së, zëvendësimin e votimit unanim me atë të shumicës së cilësuar në disa fusha të politikave të BE-së, për ta bërë këtë të fundit gati për procesin e zgjerimit. Buxheti i ardhshëm i BE-së 2028-2034 duhet t'i paraprijë përfshirjes së vendeve të reja.

Për të realizuar premtimin e një Europe të plotë, të lirë dhe në paqe, është thelbësor një riangazhim ndaj vlerave të demokracisë liberale. Prosperiteti i qëndrueshëm mund të pasojë vetëm mbi këtë bazë të nevojshme. BE-ja duhet të provojë se është i gabuar qëndrimi i atyre që mendojnë se mund të manipulojnë me vlerat dhe parimet e BE-së, respektimi i të cilave përbën domosdoshmëri për transformim demokratik e zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

## MBI AUTORËT

**Ditmir Bushati**, ish Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme, ish deputet në Kuvendin e Shqipërisë.

## IMPRINT

Fondacioni “Friedrich Ebert” | Rr. “Kajo Karafili”, Nd. 14, Hyrja 2, Kati 1 | Tiranë | Shqipëri

Përgjegjës:

**Stine Klapper** | Drejtoreshë e Fondacionit “Friedrich Ebert”, Zyra e Tiranës

Tel: +355 4 22 509 86 / 733 06

<https://tirana.fes.de/>

Menaxhere Programi:

**Mariola Qesaraku**

Faqosja:

**Enea Protopapa**

Përdorimi tregtar i të gjitha materialeve mediatike të publikuara nga Fondacioni «Friedrich-Ebert» (FES) nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të FES-it.

## NJË SHTYTJE PËR ZGJERIMIN



Takimet e përbashkëta të BE-së me Ballkanin Perëndimor nuk e mbulojnë dot simbiozën e pandershmërisë intelektuale që mbizotëron në këtë proces. Një pjesë e vendeve të rajonit presin që të promovohen duke identifikuar dobësitë ekzistuese të vetë BE-së, në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e sundimit të së drejtës.



Zhblokimi i fondeve të BE-së ndaj Hungarisë, pavarësisht rrënimit të standardeve të sundimit të së drejtës, në këmbim të lejit të vendimmarjes për hapjen e negociatave me Ukrainën, vendos pikëpyetje të forta për kushtëzimin demokratik e financiar si element i rëndësishëm në procesin e transformimit demokratik. Po të shtosh



këtu edhe raportet e Komisionit European, të cilat janë më shumë përshkruese sesa diagnostikuese, kuptohet qartë se konsolidimi i projektit european në këtë kënd të Europës kërkon para së gjithash vullnet politik të dyanshëm.

Për më shumë informacion:  
<https://www.tirana.fes.de/al/publikime/>